



Dhënien e informacionit kundrejt kërkesave të ardhura për informim brenda afatit;

Përshtypjetimin e kohës për shqyrtimin e ankesave duke ulur treguesin e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit në vlerën 10.1% nga 10.8% në vitin 2021 dhe 22.1% në vitin 2020;

Dërgimin e kërkesave drejtar autoritetet e kontraktore për zbatim vendimi, pas tejkalimit të afateve ligjore;

Regjistrimin e ankesave dhe marrjen e vendimeve nga KPP-ja gjatë periudhës ku shërbimi i dorëzimit të ankesave nëpërmjet sistemit elektronik nuk funksiononte për shkak të sulmit kibernetik;

Shpenzimet e përgjithshme bazuar në buxhetin e vitit 2022 duke u realizuar në masën 91.73%;

Konstatimin për shkelje nga KPP-ja në procedurat e prokurimit publik nga ana e autoritetet e kontraktore dhe operatorëve ekonomikë për çështje, të cilat i janë referuar për hetim administrativ Agjencisë së Prokurimit Publik;

Ngritjen e sistemit të ankesave për KPP-në (*e-anresa*), e cila ka vijuar në vitin 2022 me fazën e parë të përditësimit (*up date*) të “Sistemit të dorëzimit dhe shqyrtimit të ankesave, e dizajnuar për të përfshirë/integruar në proces digitalizimi edhe procese të tjera të brendshme administrative”;

Nënshtetjet e marrëveshjes së bashkëpunimit në tetor 2022 mes Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Antikorruptionit (ANAC), Romë, Itali;

Nënshtetjet e marrëveshjes së themelimit të rrjetit të Organeve Shqyrtuese të Prokurimit të Evropës Juglindore mes Shqipërisë, Kosovës, Kroacisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Maqedonisë së Veriut, Rumanisë, Slovениës dhe Malit të Zi, në datën 28 tetor 2022 në Tiranë;

Nënshtetjet e marrëveshjes së bashkëpunimit mes KPP-së dhe KLGJ-së në datën 6.10.2022;

Pjesëmarrjen në aktivitete gjatë vitit 2022;

Realizimin e fushatës sensibilizuese për promovimin e sistemit e-anresa për një periudhë 1-mujore, tetor–nëntor 2022;

Organizimin në bashkëpunim me SIGMA-OECD të konferencës vjetore të prokurimit publik me autoritetet kontraktore me pjesëmarrje fizike dhe *online*;

Publikimin e vazdueshëm të butetimeve mujore, si dhe dërgimin e tyre drejt autoritetet e kontraktore dhe operatorëve

ekonomikë në rrugë elektronike.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2023 kërkon që Komisioni i Prokurimit Publik të angazhohet veçanërisht në këto aspekte të veprimitarisë së tij:

1. Të realizohen dhe të merren masa konkrete në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes KPP-së dhe ANAC-së (Autoriteti Kombëtar i Antikorruptionit), nënshkruar në tetor 2022 në Romë, Itali.

2. KPP-ja të angazhohet lidhur me detyrimet që rrjedhin nga nënshtetjet e marrëveshjes së themelimit të rrjetit të Organeve Shqyrtuese të Prokurimit të Evropës Juglindore, përkatësisht për përmirësimin e bashkëpunimit, shkëmbimin e përvojave, mendimeve dhe njohurive për çështje të veçanta ligjore dhe me rëndësi në punën dhe zbatimin me cilësi dhe efektivitet të kompetencave statutore.

3. Të përballen procedurat e rekrutimit të shpallura. Gjithashtu, të nisë e të përballet edhe procesi për vendet e shtuara nga ndryshimi i strukturës së institucionit në fillim të vitit 2023.

4. Të investohet në rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore duke ndjekur praktikën e sukseshme të bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës dhe institucionet homologe jashtë vendit.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miratuar më datë 22.6.2023.

VENDIM
Nr. 382, datë 29.6.2023

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT
“STANDARDDET SHTETËRORE PËR
SPECIFIKIMET TEKNIKE TË
INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR
NË SHQIPËRI - TEMA: ZONAT ME
PËRDORIM TË KUFIZUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 2, shkronja “rr”, e 16, pika 1, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Zonat me përdorim të kufizuar”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe autoritetet përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



**STANDARDDET SHTETËRORE PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË
INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR NË SHQIPËRI.
TEMA: “ZONAT ME PËRDORIM TË KUFIZUAR”**

PËRMBAJTJA

1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE

2. HYRJE

- 2.1. Qëllimi.
- 2.2. Si lexohet dokumenti
- 2.3. Detyrimet ligjore
- 2.4. Fusha e veprimit

3. TEMA

- 3.1. Zonat me përdorim të kufizuar
 - 3.1.1. Parathënie
 - 3.1.2. Terma dhe përkufizime
 - 3.1.3. Skemat e aplikimit dhe diagrama UML për temën “Zonat me përdorim të kufizuar”
 - 3.1.4. Katalogu i tipologjive
 - 3.1.4.1. Zona e menaxhimit, kufizimit ose rregullimit
 - 3.1.4.2. Vlerat e fushës mjedisore
 - 3.1.4.3. Vlerat e kodit të llojit të zonës së specializuar
 - 3.1.4.4. Vlerat e kodit të llojit të zonës
 - 3.2. Skema e aplikimit dhe diagrama UML për nëntemën: “Aktivitetet e kontrolluara”
 - 3.2.1. Katalogu i tipologjive
 - 3.2.1.1. Zonat e menaxhimit, kufizimit dhe rregullimit
 - 3.2.1.2. Informacioni i aktivitetit të kontrolluar
 - 3.2.1.3. Dita ose data
 - 3.2.1.4. Orari
 - 3.2.1.5. Vlerat e llojit të aktivitetit të kontrolluar
 - 3.2.1.6. Vlerat e kodit të llojit të kontrollit
 - 3.2.1.7. Vlerat e kodit të llojit të ditës
 - 3.2.1.8. Vlerat e kodit të llojit të aktivitetit të specializuar
 - 3.3. Metadata
 - 3.4. Kodi EPSG për KRGJSH-në
 - 3.5. Cilësia e të dhënavës.
 - 3.5.1. Përputhja logjike – Përputhja konceptuale (Logical consistency – Conceptual consistency)
 - 3.5.2. Përputhja logjike – Përputhja me domeinin (Logical consistency – Domain consistency)

4. ANEKSE

- 4.1. Aneksi A – Katalogu i tipologjive
- 4.2. ANEKSI C - Kodlistat
 - 4.2.1. Skema e aplikimit për temën “Zonat me përdorim të kufizuar”
 - 4.2.1.1. Vlerat e fushës mjedisore
 - 4.2.1.2. Vlerat e kodit të llojit të zonës
 - 4.2.1.3. Vlerat e kodit të llojit të kontrollit
 - 4.2.1.4. Vlerat e llojit të aktivitetit të kontrolluar
 - 4.2.1.5. Vlerat e kodit të llojit të ditës
 - 4.2.1.6. Vlerat e kodit të llojit të aktivitetit të specializuar



1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE

Ky dokument përmban standardet e specifikimeve teknike të dhënave gjeohapësinore për ndërtimin e NSDI. Autor i këtij produkti është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), të cilat janë autoritete publike përgjegjëse, për temën “Zonat me përdorim të kufizuar”. Data e publikimit të versionit nr. 1 është Tetor 2020. Emërtimi i dokumentit është: ASIG_Standard_NSDI_2020_ZPK_v.1 ku:

ASIG – Autoriteti përgjegjës për krijimin e standardit

Standard – Lloji i dokumentit

NSDI – Qëllimi i dokumentit

2020 – Viti i krijimit

ZPK – Tema për të cilën është krijuar standardi: “Zonat me përdorim të kufizuar”, e cila i referohet temës “AreaManagement/ Restriction/ RegulationZonesandReportingUnits” të Direktivës INSPIRE.

v.1 – Numri i versionit të standardit

2. HYRJE

2.1. QËLLIMI

Ky dokument përcakton specifikimet teknike, për të dhënat gjeohapësinore të temës: “Zonat me përdorim të kufizuar”, temë e cila është përcaktuar në nenin 11, pika 2/rr, të ligjit nr. 72/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

Ky dokument publikohet si standard që përcakton rregullat bazë të implementimit të NSDI¹ në Shqipëri, me qëllim përdorimin e tij nga autoritetet publike përgjegjëse, për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor, që të arrihet një kuptueshmëri unike dhe korrekte e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore, për të realizuar ndërveprueshmëri midis tyre.

2.2. SI LEXOHET DOKUMENTI

2.2.1. STRUKTURA E DOKUMENTIT

Ky dokument është i organizuar në katër kapituj kryesorë:

- 1- **Përshkrimi i standardeve:** – Në këtë pjesë jepet emërtimi dhe autor i standardeve.
- 2- **Hyrje:** – Në këtë pjesë jepen përshkrime dhe shpjegime për të kuptuar mënyrën si organizohet i gjithë informacioni dhe si mund të interpretohet më lehtë ai.
- 3- **Tema:** - Në këtë pjesë jepen specifikimet teknike për temën “Zonat me përdorim të kufizuar”,

¹NSDI – Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Gjeohapësinor



4- **Anekse:** – Në këtë pjesë jepen informacione shtesë, shpjeguese, në ndihmë të përdoruesve.

- **Përbajtja e Kapitullit të 3-të është struktuar në 5 pjesë kryesore:**

- 3.1. **Përshkrimi i temës** – Në këtë pjesë flitet në mënyrë të përgjithshme për përbajtjen e temës dhe se si është e ndarë kjo temë.
- 3.2. **Përshkrimi i nëntemës së parë** – Në këtë pjesë flitet në mënyrë të përgjithshme për përbajtjen e nëntemës “Aktivitetet e kontrolluara” si dhe detajohen: Diagramat UML dhe Katalogu i tipologjive.
- 3.3. **Metadata** – Këtu jepen specifikimet teknike për metadatat e temës përkatëse.
- 3.4. **Sistemi koordinativ referencë** – Këtu përcaktohet sistemi koordinativ referencë - KRGJSH.
- 3.5. **Cilësia e të dhënave** – Këtu jepet një përshkrim mbi cilësinë e të dhënave të elementeve dhe matjes së tyre.

2.2.2. DIAGRAMAT UML DHE KATALOGU I TIPOLOGJIVE

Diagramat UML ofrojnë një mënyrë të shpejtë për të parë elementet kryesorë të specifikimeve dhe marrëdhëni të tyre. Përkufizimi mbi llojin e objektit gjehapësinor, atributet dhe marrëdhëni janë të përfshira në Katalogun e tipologjive (FeatureCatalogue). Personat të cilët kanë eksperitë tematike, por nuk janë të familjarizuar me UML-në, mund ta kuptojnë plotësisht përbajtjen e modelit të të dhënave duke u fokusuar te Katalogu i tipologjive. Për përdoruesit e aplikacioneve, Katalogu i tipologjive, mund të jetë i dobishëm për të kontrolluar nëse ai përmban të dhëna të nevojshme për përdorim.

Në tabelat e mëposhtme shpjegohet përbajtja dhe mënyra e organizimit të informacionit, në tabelat e të dhënave, në Katalogun e tipologjive.

Tabelat nr. 1, 2, me anë të shembujve, shpjegojnë mënyrën e organizimit të informacionit, në tabelën e tipologjive dhe të atributeve të tyre.

Tabela nr. 3, me anë të një shembulli, shpjegon mënyrën e organizimit të informacionit, në tabelën e kodlistës.

Tabela 1

EMRI- Emërtimi i tipologjisë

Përkufizimi	Përkufizimi për tipologjinë
Përshkrimi	Shënime dhe përshkrime të tjera për tipologjinë.
Lloji i tipologjisë	<p>Tipi i elementit që mund të jetë i këtyre llojeve:</p> <p>«FeatureType» - një element që mund të jetë real, në terren, apo një dukuri abstrakte</p> <p>«Data Type» - një element tabelor, që shërbën vetëm si tabelë atributesh, për t'u lidhur me një element tjetër</p> <p>«Enumeration «codeList» - listë e parapërgatitur vlerash, ku elementi duhet të marrë vlerë. <i>Enumeration</i> nënkupton “renditje vlerash”, ndërsa <i>codeList</i> nënkupton listë vlerash ose ndryshtë “kodlistë”. Në dokument</p>



	<p>gjenden të shqipëruara si “Numëritimet dhe kodlistat”.</p> <p>«Union» - një mbulesë topologjike e dy ose më shumë grupeve të të dhënave gjeohapësinore, që ruan tiparet, të cilat bien brenda shtrirjes gjeohapësinore të të dy grupeve të të dhënave hyrëse.</p> <p>«Imported» - të dhëna të specifikuara në tema të tjera të Direktivës INSPIRE. Në dokument gjenden të shqipëruara si “Të dhënat e importuara”</p>
Gjeometria	<p>Gjeometria e elementit sipas formatit vektor mund të gjendet në tri forma: pikë, linjë, poligon.</p> <p>Abstrakt – kur elementi nuk është element real në terren, por konsiderohet vetëm si dukuri.</p>
Shumëlojshmëria	<p>Lloji dhe numri i vlerave që mund të marrë atributi:</p> <p>0..* - mund të marrë shumë lloje vlerash ose asnjë vlerë</p> <p>1..* - mund të marrë minimumi 1 vlerë ose shumë vlera</p> <p>0..1 - mund të mos marrë asnjë vlerë ose nëse merr vlerë, duhet të marrë vetëm 1 vlerë të vetme.</p> <p>1 - duhet të marrë detyrimisht 1 vlerë</p>
I detyrueshëm	<p>Po – nëse atributi është i detyrueshëm të plotësohet</p> <p>Jo – nëse atributi nuk është i detyrueshëm të plotësohet</p>
Rol shoqërimi	Në tabelën e lidhjeve “Rol shoqërimë” tregohen marrëdhënet hierarkike ndërmjet elementeve të ndryshme në këtë temë, si dhe në temat e tjera. Këto marrëdhënie pasqyrojnë lidhjet që realizohen në skemat UML.
Atributet	« Atribut » - janë informacione të bashkëngjitura në format tabelor tek tipologjitet gjeohapësinore.

Tabela 2

ATRIBUTET
-- Emri --
Emërtimi i atributit
-- Përkufizimi --
Përkufizimi i elementeve
-- Përshkrimi --
Shënime dhe përshkrime të tjera për elementin [I detyrueshëm: Detyrueshmëria, nëse atributi duhet të marrë vlerë, p.sh: PO]



Tabela 3

ATRIBUTET
◆ Vlera e parë e listës së gatshme, p.sh: Ligjor
-- Emri -- Emërtimi i vlerës
-- Përkufizimi -- Përkufizimi i elementeve.
◆ Vlera e dytë (etj.) e listës së gatshme, p.sh: Joligjor
-- Emri -- Emërtimi i vlerës
-- Përkufizimi -- Përkufizimi i elementeve.

2.2.3. KARAKTERISTIKAT <<VOIDABLE>> DHE SHUMËLLOJSHMËRIA

Stereotipi <<voidable>> përdoret për të përshkruar ato karakteristika të objekteve gjeohapësinore që mund të jenë ose mund të mos jenë të pranishme në grupet e të dhënave gjeohapësinore edhe pse mund të ekzistojnë në realitet. Kjo nuk do të thotë që këtyre përkatësive duhet t'u jepet një vlerë.

Për të gjitha karakteristikat, e përcaktuara për objektet gjeohapësinore, duhet të paraqitet një vlerë – ose vlera përkatëse (nëse është e disponueshme në grupin e të dhënave që mirëmbahet nga ofruesi i të dhënave), ose vlera ‘void’. Një vlerë ‘void’ nënkupton që nuk ekziston një vlerë përkatëse, në grupet e të dhënave gjeohapësinore, që mirëmbahen nga ofruesi i të dhënave ose që asnjë vlerë përkatëse nuk mund të nxirret nga vlerat ekzistuese.

Arsyeja e përdorimit të vlerës ‘void’ duhet të paraqitet kurdo që të jetë e mundur, duke përdorur një nga vlerat e listuara në kodlistën *VleraEArSysesSëPavlefshmërisë*(VoidReasonValue), e cila përmban:

- **E panjohur** (Unknown)

-- **Përkufizimi** --

Vlera korrekte për këtë element gjeohapësinor nuk njihet ose është e pamatshme nga krijuesi i të dhënave.

-- **Përshkrim** --

Shembull: Kur “kuota e sipërfaqes së një trupi ujor nga niveli i detit” e një liqeni të caktuar, nuk është matur, atëherë arsyja e pavlefshmërisë së kësaj karakteristike mund të jetë “E panjohur”.

- **E papopulluar** (Unpopulated)

**-- Përkufizimi --**

Kjo karakteristikë nuk është pjesë e databazës së mirëmbajtur nga krijuesi i të dhënave. Pavarësisht kësaj kjo e dhënë mund të ekzistojë.

-- Përshkrimi --

Shembull: Kur “kuota e sipërfaqes së një trupi ujor nga niveli i detit” nuk është e përfshirë në grupin e të dhënave që përmban objektin gjeohapësinor të liqenit, atëherë vlera e kësaj karakteristike mund të jetë “E pa populluar”

- **Konfidenciale** (Withheld).

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë mund të ekzistojë por është konfidenciale.

-- Përshkrimi --

Shembull: Të dhënat personale të popullatës, të cilat ekzistojnë, por që nuk mund të shfaqen pasi mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Stereotipi <> nuk jep asnjë informacion nëse ekziston një karakteristikë në realitet. Kjo shprehet duke përdorur shumëllojshmërinë:

Nëse një karakteristikë mund të ekzistojë apo mund të mos ekzistojë në realitet, vlera minimale do të përcaktohet si 0. P.sh. nëse një adresë ka apo nuk ka një numër shtëpie, shumëllojshmëria përkatëse do të jetë 0..1.

Nëse për një karakteristikë të caktuar ekziston të paktën një vlerë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 1. P.sh. nëse një njësi administrative ka gjithmonë të paktën një emër, shumëllojshmëria përkatëse do të jetë 1..*.

2.2.4. MBULIMET - COVERAGES

Funksionet e mbulimit “Covernages” përdoren për të përshkruar karakteristikat e një fenomeni në realitet që zhvillohet në kohë dhe/ose hapësirë. Shembuj tipik të tyre janë temperaturat, lartësitë, imazheritë etj. Një mbulim përmban një grup vlerash, të cilat shoqërohen me një element gjeohapësinor, kohor, kohor-gjeohapësinor. Domeinet tipike gjeohapësinore janë grupe pikash (p.sh. vendndodhja e sensorëve), kurbat përcaktuese (p.sh. izolinjat), rrjetet (p.sh. ortoimazheria, modelet e lartësive) etj.

Në skemat e aplikimit të INSPIRE, funksionet e mbulimit janë përcaktuar si veti të llojeve të objekteve gjeohapësinore, ku lloji i vlerës së kësaj karakteristike është realizim i një prej llojeve të specifikuara në SSH EN ISO 19123.

Për të përmirësuar përputhjen me standarde mbulimit nё nivelin e zbatimit (p.sh. SSH EN ISO 19136-1 dhe OGC Shërbimi i Mbulimit nё Internet) dhe për të përmirësuar harmonizimin ndërtematik, për përdorimin e mbulimeve nё INSPIRE, një skemë e aplikimit për llojet e mbulimit është përfshirë nё “Modelin konceptual të përgjithshëm” (GenericConceptual Model).

Kjo skemë aplikimi përmban llojet e mëposhtme të mbulimit:



- *RrjetiIMbulimitIKorriguar (rektifikuar)*: Mbulimi, domeini i të cilit përbëhet nga një rrjet i korriguar, një rrjet përfundimtar midis koordinatave të rrjetit dhe koordinatave të sistemit koordinativ referencë. (shih figurën 1, majtas).
- *RrjetiIMbulimitReferencë*: Mbulimi, domeini i të cilit përbëhet nga një rrjet referimi, një rrjet i lidhur me një transformim që mund të përdoret përfundimtar midis koordinatave të rrjetit në vlera të koordinatave të referuara në një sistem referimi koordinativ (shih figurën 1, djathtas).

Aty ku është e mundur përdoren vetëm këto lloje mbulimi (ose një nëntip i tyre) në skemat e aplikimit në INSPIRE.




Figura 1 – Shembuj të një rrjeti të korriguar (majtas) dhe një rrjeti referues (djathtas)

2.2.5. NUMËRTIMET DHE KODLISTAT (ENUMERATION AND CODE LIST).

Kodlistat modelohen si klasa në skemat e aplikimit, por vlerat e tyre menaxhohen jashtë skemave të aplikimit. Në kodlistën, ‘vlera të tjera’ përcaktohet lloji i përmbajtjes së kodlistës, e përcaktuar specifisht si më poshtë:

- ‘*jo*’ përfaqëson kodlista që përmbajnë vetëm vlera të specifikuara në këtë dokument.
- ‘*të kufizuara*’ përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të specifikuara në këtë dokument dhe vlera të tjera të limituara të përcaktuara nga ofruesi i të dhënavë.
- ‘*të hapura*’ përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të specifikuara në këtë dokument dhe vlera shtesë në çdo nivel, të përcaktuara nga ofruesi i të dhënavë.
- ‘*po*’ përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të përcaktuara nga ofruesi i të dhënavë.

Vlerat shtesë, të përcaktuara nga ofruesit e të dhënavë, nuk duhet të zëvendësojnë, apo të modifikojnë, vlerat ekzistuese, të përcaktuara në dokument.

Në rastin kur ofruesit e të dhënavë do të përdorin kodlista me vlera ‘*jo*’, *pra* të specifikuara në dokument, ofruesit janë të detyruar t’i bëjnë këto vlera bashkë me përkufizimet e tyre, të disponueshme në një regjistër. Kjo do të mundësojë që edhe përdoruesit e tjerë t’i kuptojnë këto vlera dhe të kenë mundësi t’i përdorin.

2.2.6. PARAQITJA E DIMENSIONIT KOHOR

Skemat e aplikimit përdorin atributin “*FillimiICiklitJetësor*” dhe “*PërfundimiICiklitJetësor*” përfundimtar midis koordinatave të sistemit referencë.



Atributi “*FillimiICiklitJetësor*” specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është futur apo ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Atributi “*PërfundimiICiklitJetësor*” specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është zëvendësuar apo tërhequr nga grupi i të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Këto vlera kohore nuk kanë të bëjnë me karakteristikat kohore të objektit në botën reale.

Ndryshimet që bëhen në atributin “*PërfundimiICiklitJetësor*” nuk shkaktojnë ndryshime në atributin “*FillimiICiklitJetësor*”.

❖ ***Shënim i rëndësishëm:***

Disa terma në Katalogun e tipologjive, si p.sh. FeatureType, DataType, Void, Coverages etj., nuk janë përkthyer qëllimi parësor është që të mos humbasin kuptimin gjatë përkthimit dhe së dyti të përdoret një gjuhë unike sipas termave të Direktivës INSPIRE.

2.3. DETYRIMET LIGJORE

Në bazë të nenit 16, të ligjit nr. 72/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, ASIG është institucioni përgjegjës për krijimin e standardeve, për secilën nga temat e përcaktuara në nenin 11, të këtij ligji, në përputhje me standardet evropiane (Direktiva INSPIRE).

Standardet teknike të të dhënave gjeohapësinore, për krijimin e NSDI në Shqipëri, janë përshtatur nga specifikkimet teknike të temave përkatëse në Direktivën INSPIRE si dhe nga praktikat më të mira ndërkombëtare që mbështesin dhe bazohen në këtë direktivë. Për implementimin e direktivës, kërkohet që të gjithë aktorët të zbatojnë disa standarde të përbashkëta, të cilat mundësojnë ndërveprimin e shërbimeve dhe harmonizimin e të dhënave gjeohapësinore.

Standardet (Rregullat e implementimit - IR) duhet të krijohen për fushat e mëposhtme:

- **Metadata** – në këtë fushë direktiva përcakton standardet se si duhen të jenë metadatat. Ky standard është unik dhe i aplikueshëm për të gjitha institucionet ose palët e treta (sikurse është e përcaktuar në fushën e veprimit të kësaj direktive), të cilat do ta implementojnë atë.(VKM nr. 1077, datë 23.12.2015)
- **Specifikimi i të dhënave** – standardet e kësaj kategorie përfshijnë të gjitha atributet e objekteve të ndryshme që do të publikohen. INSPIRE ka përcaktuar disa atribute bazë të cilat do të shërbejnë për publikimin e të dhënave të ndryshme. Vendet e ndryshme, në varësi të ligjeve ose të nevojave të brendshme, mund të shtojnë atribute të tjera për t'i bërë sa më të përdorshme të dhënat. Të gjitha të dhënat që do të shtohen duhet të jenë të dokumentuara dhe të miratuara nga institucionet përgjegjëse lokale.



2.4. FUSHA E VEPRIMIT

Të gjithë autoritetet publike, kompanitë private apo individë që mbajnë ose përpunojnë të dhëna gjeohapësinore për llogari të institucioneve publike, janë të detyruar t'i nënshtronen këtij standardi.

Bazuar në modelet e proceseve të biznesit, sistemi i propozuar nga Direktiva INSPIRE ka proceset dhe ciklin jetësor, si më poshtë:




Figura 2: Proseset e ciklit jetësor

Planifikimi – Është procesi gjatë të cilil krijohen strukturat e të dhënavëve të nevojshme për të publikuar informacionin në portal. Rezultatet e këtij procesi janë modelet e ndryshme të të dhënavëve.

Vlerësimi – Është procesi gjatë të cilil të dhënat ekzistuese testohen kundrejt modelit. Rezultati i këtij procesi do të jetë certifikimi i të dhënavëve ose nevoja për të modifikuar të dhënat që të përshtaten me modelet e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit.

Procesimi (Përpunimi) – Është procesi gjatë të cilil mblidhen dhe modifikohen atributet e të dhënavëve për të prodhuar informacion kuptimplotë. Manipulimi i tyre bëhet kundrejt modeleve të përcaktuara gjatë planifikimit. Rezultatet e këtij procesi janë bashkësi të dhëash gati për t'u publikuar.

Shpërndarja – Është procesi gjatë të cilil vihen në dispozicion përdoruesit (qytetarët, autoritetet publike, organizatat ose palët e treta). Përdoruesi mund të shkarkojë, të përdorë, të analizojë ose të citojë të dhënat. Publikimi i të dhënavëve bazohet në modelet e ndryshme të përdorimit.

Zbulimi – Është proces i vazhdueshëm gjatë të cilil zbulohen të dhëna të reja ose të dhëna jocilësore në të dhënat e publikuara.

Analiza – Është procesi i analizimit të të dhënavëve të evidentuara në fazën e zbulimit. Gjatë këtij procesi merret vendimi çfarë do të bëhet me të dhënat që janë evidentuar.

Përditësimi – Është procesi kur propozohet shtimi, modifikimi ose fshirja e të dhënavëve. Ky proces regjistrohet nga procesi i analizimit të të dhënavëve ekzistuese dhe të publikuara.

Arkivimi – Është procesi gjatë të cilil bashkësitë e të dhënavëve që nuk nevojiten të aksesohen, arkivoohen duke u bazuar në standarde kombëtare dhe në legjislacionin në fuqi të vendit ku implementohet standardi. Rezultat i këtij procesi janë të dhënat që bëhen të pa aksesueshme për publikun, me akses vetëm nga autoritetet specifike. Këto të dhëna vazhdojnë të ruhen, përsye të përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi ose me standartet specifike.

Shkatërrimi – Është procesi gjatë të cilil të dhënat bëhen të parikuperueshme. Ky proces bazohet në standarde kombëtare dhe në legjislacionin në fuqi.



3. TEMA

3.1. ZONAT ME PËRDORIM TË KUFIZUAR

3.1.1. PARATHËNIE

Tema “Zonat me përdorim të kufizuar” përfshin të dhënët gjeohapësinore për zonat e menaxhimit, kufizimit, rregullimit dhe njësisë së raportimit të cilat përdoren për raportime në nivele ndërkombëtare, evropiane, kombëtare, rajonale dhe lokale. Udhëzimet teknike për specifikimin e të dhënavëve, specifikojnë një gamë të gjërë të llojeve të zonave që janë krijuar ose përdorur për katër koncepte të ndryshme dhe nganjëherë mbivendosëse: menaxhimi, kufizimi, rregullimi dhe raportimi.

Udhëzimet e temës “Zonat me përdorim të kufizuar”, pasqyrojnë dy koncepte themelore:

1. Nevoja për informacionin gjeohapësinor në zonat ku janë vendosur regjimet për specifikimin e menaxhimit, kufizimit ose rregullimit.
2. Përkufizimet e “njësive raportuese” përfshirë specifikimet e INSPIRE për temën “Zonat me përdorim të kufizuar”.

Kjo temë përfshin zonat e menaxhimit, kufizimit ose rregullimit, që janë zona të krijuara në përpjekje me kërkeshat specifike legislative, për të ofruar objektiva mjedisore që lidhen me çdo fushë mjedisore, për shembull, ajri, uji, toka, biota (bimë dhe kafshë), burimet natyrore, toka dhe përdorimi i tokës.

Kjo përfshin, por nuk kufizohet në objektivat e përcaktuara për:

- Mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit (përfshin uljen e niveleve të ndotjes)
- Mbrojtjen dhe konservimin e burimeve mjedisore dhe natyrore
- Mbrojtjen dhe kontrollin e riskut nga rreziqet natyrore dhe ato të bëra nga dora e njeriut
- Mbrojtjen e shëndetit të bimëve, kafshëve dhe njerëzve
- Kontrollin e zhvillimit dhe planifikimit gjeohapësinor

Për të arritur këto objektiva, zakonisht përcaktohet një autoritet kompetent i cili është përgjegjës për shpërndarjen, rregullimin dhe monitorimin e objektivave specifike mjedisore që mund të përcaktohen brenda planit të menaxhimit ose veprimit.

Modeli konceptual i temës “Zonat me përdorim të kufizuar” përcakton një model të përgjithshëm bazë që përfshin zonat e menaxhimit, kufizimit dhe konceptet e rregullimit, duke përdorur një grup të paracaktuara të llojeve të zonave të cilat mund të zgjerohen duke shtuar llojet e zonave të specializuara. Ky modelim të dhëna përdoret për të shkëmbyer të dhëna gjeohapësinore midis domeineve të ndryshme dhe autoritetet publike.

Njësitë e raportimit bazohen në detyrimet e përcaktuara ligjërisht në raportimin mjedisor. Objektet gjeohapësinore të ndryshme, të përcaktuara brenda temave të ndryshme të dhënavëve gjeohapësinore dhe mënyra se si realizohen njësitë raportuese të dhënavëve gjeohapësinore shprehet me kërkesa specifike.

Tema “Zonat me përdorim të kufizuar” siguron informacione se si të bëhet dallimi midis kësaj teme dhe temave të tjera, ku midis tyre ekzistojnë marrëdhënie të ngushta me të dhënët gjeohapësinore. Vendimi për këto marrëdhënie jepen në bazë të:

- ngjashmërisë së qëllimit të temës
- marrëdhënieve konceptuale
- ndarjeve të së njëjtës gjeometri si një objekt gjeohapësinor

Tema “Zonat me përdorim të kufizuar” përfshin raste të përdorimit, të cilat janë përdorur si bazë e procesit të zhvillimit të specifikimeve dhe shembuj se si të sigurohen të dhëna bazuar në menaxhimin dhe



kufizimin e zonës. Skema e aplikimit të zonave të menaxhimit, kufizimit dhe rregullimit do të zgjerohet sipas modelit konceptual të paraqitur në skemat e specifikuve teknike për këtë temë.

Kjo temë përfshin vendet e shkarkimit, zonat e kufizuara rrëth burimeve të ujët të pijshëm, zonat të rezikuara nga nitrati, rrugët detare ose ujërat e mëdha në brendësi, zonat për hedhjen e mbeturinave, zonat e kufizimit të zhurmës, zonave të kërkimit dhe lejes së minierave, rrathët e pellgjeve lumore, njësitë përkatëse të raportimit dhe zonat e menaxhimit të zonës bregdetare.

Kjo temë është shumë e gjerë dhe përfshin një gamë të madhe të llojeve të zonave që janë themeluar ose përdorur për katër koncepte të ndryshme dhe nganjëherë mbivendosëse:

- **Menaxhimi:** zonat janë krijuar për të planifikuar, kryer, monitoruar dhe kontrolluar aktivitetet për të arritur objektiva mjedisore të cilat janë specifika të përcaktuara në ligj. Shembujt përfshijnë: zonat e menaxhimit të cilësisë së ajrit, lumenj, pellgje, zonat e menaxhimit bregdetar.

Shënim: Qëllimet mund të janë të vazhdueshme, p.sh. mirëmbajtja e një gjendje të caktuar mjedisore.

- **Kufizimi:** zonat janë krijuar për të ndaluar ose kufizuar aktivitete të caktuara, që të kryhen vetëm brenda kufijve specifikë dhe/ose periudhat kohore, në mënyrë që të arrihet një qëllim i caktuar sipas përgjegjësive ose detyrimeve të përcaktuara me ligj. Shembujt përfshijnë: zonat e kufizimit të zhurmës dhe zonat kufizuese për shëndetin e kafshëve.

- **Rregullimi:** zona që janë krijuar për të monitoruar dhe kontrolluar aktivitete të caktuara (për të lejuar, promovuar, ndaluar ose kufizuar) për të arritur objektiva mjedisore të përcaktuara me ligj. Një aktivitet i rregulluar mund të kërkojë që nëse statusi mjedisor është i degraduar, atëherë duhet të zbatohen veprime të veçanta si rivendosja e statusit të mirë mjedisor.

Shënim 1: Në raste specifike, një regjim rregulator mund të përcaktojë një grup të kufirit/pragut të pranueshëm, vlera për të mbrojtur shëndetin e njeriut ose mjedisin.

Shënim 2: Dallimi midis rregullimit dhe kufizimit nuk është gjithmonë i qartë, pasi kufizimi i aktiviteteve nënkuption që ato janë të rregulluara.

- **Raportimi:** për të vlerësuar efikasitetin e politikave për mjedisin dhe publikimin e të dhënave dhe informacioneve (p.sh. të dhëna gjeohapësinore, vrojtime, statistika, tregues) të cilat mund të përdoren për të vlerësuar progresin drejt ruajtjes dhe përmirësimit të statusit të një ambienti të mirë dhe arritjen e objektivave të politikave.

Shënim 1: Secili vend përgjegjës për krijimin e këtij standardi, duhet të sigurojnë rregullisht të dhëna dhe informacione drejt autoritetit përgjegjës, i cili është Komisioni (d.m.th. raportime) të cilat mund të analizohet për të vlerësuar gjendjen e mjedisit.

Shënim 2: Raportimi i të dhënave dhe informacionit mund të publikohet përafersisht në kohë reale (mbas kontrollit) ose mund të publikohet në mënyrë periodike (zakonisht në intervale 3 vjeçare), siç është përcaktuar në legjACIONIN përkatës.

Qëllimi i temës “Zonat me përdorim të kufizuar” përcaktohet në tre çështje kryesore siç përmenden :

- Sa të gjera duhet të janë zonat tematike? Zonat tematike mbulojnë një gamë të gjerë veprimtarish socio-ekonomike, politikat që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm dhe politikat që lidhen me mbrojtjen e çështjeve mjedisore.
- Kërkесat për zonat e menaxhuara, të rregulluara ose të përdorura për raportim janë të ndryshme në nivele të ndryshme të administrimit dhe legjACIONIT ndërkombëtar, evropian, kombëtar dhe rajonal\lokale cilat ndikojnë në mënyrën e përcaktimit ose të vendosjes së zonave.
- Si të balancojmë kërkësat për të përfshirë të gjitha fushat tematike përkatëse INSPIRE, me nevojën për një nivel më të thellë të detajuar brenda zonave individuale tematike?



Përkufizimi i temës së të dhënave gjeohapësinore “*Zonat me përdorim të kufizuar*” dhe “njësitë raportuese” pasqyron dy koncepte themelore:

- nevojën për informacion gjeohapësinor për fushat ku menaxhimi specifik është rregullues ose regjimet kufizuese janë ekzistuese si dhe roli i objekteve gjeohapësinore si njësi raportuese.

Fushëveprimi në lidhje me menaxhimin, kufizimin dhe rregullimin e zonës

Ka disa kufij në temën “*Zonat me përdorim të kufizuar*” që janë zona të krijuara në përputhje me kërkesat specifike legislative për të dhënë objektiva specifike të mjedisit që lidhen me çdo media mjedisore, për shembull, ajri, uji, toka dhe biota (bimë dhe kafshë). Kjo përfshin, por nuk kufizohet në, objektiva të përcaktuara për:

- Mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit (përfshin uljen e niveleve të ndotjes).
- Mbrojtjen dhe konservimin e burimeve mjedisore dhe natyrore.
- Mbrojtjen dhe kontrollimin e riskut nga rreziqet natyrore dhe ato të bëra nga dora e njeriut.
- Mbrojtjen e shëndetit të bimëve, kafshëve dhe njerëzve.
- Kontrollimin e zhvillimit dhe planifikimit gjeohapësinor.

Për të arritur këto objektiva, zakonisht përcaktohet një autoritet kompetent i cili është përgjegjës për shpërndarjen, rregullimin dhe monitorimin e objektivave specifike mjedisore që mund të përcaktohen brenda planit të menaxhimit ose veprimit. Brenda planeve ose programeve të tilla, mund të përcaktohen masa që kërkojnë të kontrollojnë aktivitete specifike (leje, promovim, ndalim ose kufizim). Aktivitete të tilla mund të kontrollohen përgjatë periudhave të vazhdueshme kohore ose vetëm brenda orareve specifike. Për shembull, nivelet e zhurmës nga një vend argëtimi nuk mund të tejkalojnë vlerat e pragut të pranueshëm midis orës 23:00 dhe 08:00, nga e diela deri të enjten dhe midis 12 të mesnatës dhe 08:00 të premten dhe të shtunën.

Kufizim i menaxhimit ose zona të rregullimit, do të jetë çdo zonë e krijuar në përputhje me kërkesat legislative të lidhura me politikat mjedisore ose çdo politikë ose veprimitari që mund të ketë ndikim në mjedis në çfarëdo nivel administrimi (ndërkombëtar, evropian dhe kombëtar) të mundshëm.

Nëse një zonë është krijuar për menaxhimin, kufizimin ose rregullimin por nuk është e mbështetur në një kërkesë legislative, mund të kodohet si një zonë me përdorim të kufizuar, por kjo nuk kërcohë sipas rregullave zbatuese të INSPIRE.

Kjo temë është modeluar për të siguruar shtrirjen e saj, si dhe mbështetjen e llojeve të zonave të menaxhimit, kufizimit dhe rregullimit të zonës të cilat nuk kanë qenë të identikuara gjatë fazës së zhvillimit të temës. Llojet e identikuara të zonës përcaktohen në kodlistën *Kodi I Llojit Të Zonës*.

Qasja e modelimit

Modelimi konceptual i temës “*Zonat me përdorim të kufizuar*” përfshin vetitë thelbësore të kërkua të përcaktimin e zonës së menaxhimit, kufizimit, rregullimit dhe trajtimit veçmas i konceptit të njësive raportuese.

Menaxhimi, kufizimi dhe rregullimi lidhen me fushat ku këto detyrime kryhen dhe ekzekutohen. Një zonë specifike mund të jetë në të njëjtën kohë subjekt i kufizimeve/rregulloreve ose regjimeve të menaxhimeve të ndryshme, të cilat mund të përcaktojnë veprimitari të larmishme brenda atyre zonave. Për shembull: të njëjtat fusha fizike mund të kenë kufizime, veprime specifike të menaxhimit, plus kërkesave për raportim, të tilla si “plotësimi dhe riparimi i erozionit të plazhit” të gjitha këto të mandatuara nga legjislacione dhe rregullore të niveleve të ndryshme - evropiane, kombëtare dhe nënkombeitar (rajonal dhe lokal) dhe të shkallëve të ndryshme.



Kufijtë e zonave nuk zbatohen domosdoshmërisht për kufijtë natyrorë gjeografikë ose dukuritë e natyrës dhe ato mund të bazohen në një vendim të autoriteteve përgjegjëse. Për shembull:

-një grup i njësive administrative lokale ose pjesët e tyre mund të përbëjnë një zonë aglomerimi,
-zonat kufizuese rreth bregdetit, liqenet ose lumi zakonisht mbulojnë zonat përreth tyre dhe përcaktohen brenda zonave të autoriteteve përgjegjëse (njësi administrative ose njësi të tjera organizative territoriale),ose rrathët e pellgjeve të lumenjve korrespondojnë me kufijtë e vendit (kombëtar) pavarësisht rrjedhës natyrore të lumenjve përgjatë shumë vendeve.

Ky modelim i përgjithshëm mund të përdoret për të shkëmbyer të dhëna gjeohapësinore midis domeineve të ndryshme dhe autoriteteve publike. Pritet që ky modelim i përgjithshëm dhe thelbësor të zgjatet për të përcaktuar objekte gjeohapësinore që përmbanjë veti shtesë specifike për domeinin.

Njësitë raportuese

Tema “Zonat me përdorim të kufizuar” përfshin “njësitë raportuese” si një objekt gjeohapësinor që ofron referencën gjeohapësinore për çdo të dhënë jo gjeohapësinore e shkëmbyer nën detyrimet e raportimit mjesidori.

Të dhënat jo gjeohapësinore të raportuara duhet të përfshijnë një veti që përmban një referencë për objektin gjeohapësinor. Ky është zakonisht një identifikues, kod ose emër dhe është një çelës bashkimi midis objekteve gjeohapësinore dhe atyre jo gjeohapësinore, të cilat mundësojnë kombinimin e të dhënavë. Kjo lejon që të dhënat jo gjeohapësinore të vizualizohen si harta ose të mundësojnë analiza gjeohapësinore.

Shembull: Në tabelën e mëposhtme është një shembull i disa të dhënavë vjetore të raportuara për tejkalinin e cilësisë së ajrit për Sllovaninë nga viti 2006. Këto të dhëna të raportuara përmbanjë një çelës bashkimi (kodi i zonës) në Zonën e Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit i cili është një lloj i zonave me përdorim të kufizuar. Kur Zonat me përdorim të kufizuar, të jenë të bashkuara në Njësinë e Raportimit, krijohet një hartë e re për të vizualizuar tejkalinin (fig. 3).

- Form 8a List of zones in relation to limit value exceedances for SO ₂		
Zone code	LV for health (24hr mean)	
	>LV	<LV
SKBA01.1		y
SKBA02		y
SKBB01		y
SKKO01.1		y
SKKO02		y
SKNI01		y
SKPR01		y
SKTN01		y
SKTR01		y
SKZI01		y

Tabela 1 - Kapercimi i vlerave limit SO2 në Sllovania raportuar EEA-së në 2006.




Figura 3 - Harta vizualizon tejkalimin e vlerave kufitare ditore të SO₂ brenda Zonave të Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit në Evropë.

Sidoqoftë, Zonat me përdorim të kufizuar nuk janë lloj i vetëm i "Njësisë së raportimit". Objektet e tjera gjehapësinore kryejnë rolin e "Njësisë së raportimit". Për shembull, ujërat sipërfaqësorë: lumenj, liqene dhe kanale. Ujërat fizikë janë "Njësi raportuese" për treguesit e gjendjes kimike dhe ekologjike (figura 4). Kështu, njësitë raportuese nuk mund të modelohen si një lloj objekti gjehapësinor i veçantë. Prandaj, nuk ka asnjë skemë aplikimi të njësive raportuese të përfshira në këtë specifikim të dhënash.

Rekomandimi 1: Kur një objekt gjehapësinor kryen rolin e "Njësisë së raportimit", rekomandohet fuqimisht që ajo të ketë një mënyrë që të dhënat e raportimit të mund t'i referohen objektit gjehapësinor.




Figura 4 - Harta vizualizon statusin ekologjik ose potencialin për lumenjtë, kanalet dhe ujërat sipërfaqësore (2009).

Zgjerimi i specifikimit të të dhënave Zonat me përdorim të kufizuar

Për shkak të shtrirjes së gjerë të temës është krijuar modelimi konceptual që përfshin, një zonë të përgjithshme menaxhimi, kufizimi dhe rregullimi të objektit gjeohapësinor të zonës e cila mund të klasifikohet duke përdorur tipin e zonës dhe vetitë e llojit të specializuar të zonës.

Shënim: Llojet e zonës dhe vlerat e specializuara të klasifikimit të kodit të zonave janë të lejueshme dhe lejojnë komunititet tematike dhe shtetet përgjegjëse të propozojnë lloje shtesë zonash që nuk janë identifikuar gjatë fazës së zhvillimit të specifikimit të të dhënave për *Zonat me përdorim të kufizuar*.

Ky objekt gjeohapësinor përcakton një grup thelbësor të veticë që vlejnë për çdo zonë. Modeli i përgjithshëm mund të përdoret për të shkëmbyer të dhëna gjeohapësinore midis domeineve të ndryshme dhe autoriteteve publike. Pritet që ky model i përgjithshëm thelbësor të zgjatet për të përcaktuar objektet gjeohapësinore që përbajnë vetitë shtesë specifike të domeinit (Figura 5).




Figura 5 - Zgjerimi i skemës së aplikimit Zonat me përdorim të kufizuar për të gjeneruar skema tematike të aplikimit.

Lidhja midis temës “Zonat me përdorim të kufizuar” dhe temave të tjera të Direktivës INSPIRE

- Dallimi kryesor midis dy temave “*Zonat me përdorim të kufizuar*” dhe “*Zonat e mbrojtura*” është se, *Zonat e mbrojtura* janë krijuar për të menaxhuar, rregulluar dhe kufizuar aktivitetet vetëm për të ruajtur natyrën, biodiversitetin dhe trashëgiminë kulturore. Disa zona të menaxhimit, kufizimit dhe rregullimit janë krijuar për të ofruar shumë objektiva mjedisore që përfshijnë natyrën dhe ruajtjen e biodiversitetit (p.sh. rrahët e baseneve të lumenit). Kur kjo ndodh, objektet gjeohapësinore duhet të publikohen vetëm një herë, si një zonë menaxhimi, kufizimi dhe rregullimi.

Nëse një zonë është krijuar ekskluzivisht për të menaxhuar, rregulluar dhe kufizuar aktivitetet e saj për të ruajtur natyrën, biodiversitetin dhe trashëgiminë kulturore, ai do të vihet në dispozicion si një objektiv gjeohapësinor i mbrojtur. Nëse një zonë është krijuar për të dhënë objektiva të shumëfishtë, përfshirë



ruajtjen e natyrës, biodiversitetit dhe trashëgimisë kulturore, do të bëhet e disponueshme si një objekt gjeohapësinor i zonës së menaxhimit, kufizimit ose rregullimit.

- Për të kontrolluar zhvillimin në mjediset tokësore dhe detare, janë krijuar zona rregullimi. Këto përcaktojnë kontolle specifike për rregullimin e veprimtarive të veçanta siç është ndërtimi i objekteve sipër një lartësie të specifikuar ose një lloji specifik brenda një zone. Kur zona të tilla përcaktohen brenda një plani gjeohapësinor ligjërisht të detyrueshëm ato përfshihen në fushën e përdorimit të tokës dhe duhet të përcaktohen duke përdorur rregullimin plotësues, të llojit të objektit gjeohapësinor brenda skemës së planifikuar të përdorimit të tokës.

Nëse zonat janë krijuar, por nuk përcaktohen brenda një plani gjeohapësinor ligjërisht të detyrueshëm, ato duhet të jenë të përcaktuara si; *Zonë menaxhimi, Kufizimi dhe Zonë rregullimi*. Kur një zonë është krijuar për të rregulluar përdorimin e tokës sipas planifikimit dhe për të përcaktuar brenda një plani gjeohapësinor ligjërisht të detyrueshëm, ai hyn në fushën e përdorimit të tokës dhe do të bëhet i disponueshëm si një rregullim plotësues.



3.1.2. TERMA DHE PËRKUFIZIME

Termat dhe përkufizimet e përgjithshme të dobishme për të kuptuar që dokumenti i specifikimeve të të dhënave gjeohapësinore për temën “*Zonat me përdorim të kufizuar*”.

Konkretilisht, për temën “*Zonat me përdorim të kufizuar*” përcaktohen termat e mëposhtëm:

- **Menaxhimi** - Planifikon, plotëson, monitoron dhe kontrollon aktivitete për të arritur objektiva specifike mjedisore të përcaktuar me ligj.
- **Kufizimi** - Ndalon ose kufizon aktivitete të caktuara, të kryhen vetëm brenda kufijve specifikë ose afateve kohore, me qëllim të arritjes së një objektivi të caktuar sipas përgjegjësive ose detyrimeve të përcaktuara me ligj.
- **Rregullimi** - Monitoron dhe kontrollon aktivitete të caktuara (për të lejuar, promovuar, ndaluar ose kufizuar) për të arritur objektiva mjedisorë të përcaktuara me ligj. Një aktivitet i rregulluar mund të kërkojë që nëse statusi mjedisor është degraduar, atëherë veprime të veçanta duhet të miratohen për të rikthyer statusin e mirë mjedisor.
- **Raportimi** - Vlerëson efektivitetin e politikave mjedisore dhe publikon të dhëna dhe informacione (d.m.th. të dhëna gjeohapësinore, vëzhgime, statistika, tregues) që mund të përdoren për të vlerësuar progresin drejt ruajtjes ose përmirësimit të statusit të mirë mjedisor dhe arritjes së objektivave të politikës.
- **Njësia raportuese** - Objekt gjeohapësinor që ofron referencën gjeohapësinore për çdo të dhënë jo hapësinore të shkëmbyer nën detyrimet e raportimit mjedisor.
- **Instrumentet ligjore** - Një dokument që specifikon detyrimet ligjore duke përfshirë, por pa u kufizuar në konventa ndërkombëtare, ligjet dhe aktet ligjore ose rregulloret zbatuese në çdo nivel administrativ.
- **Menaxhimi i integruar i zonës bregdetare** - Menaxhimi i integruar i zonës bregdetare është një proces dinamik për menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të zonave bregdetare, duke marrë në të njëjtën kohë dobësinë e ekosistemeve dhe peizazheve bregdetare, larminë e aktiviteteve dhe përdorimeve, ndërveprimet e tyre, orientimin detar të aktiviteteve të caktuara, përdorimet dhe ndikimin e tyre si në pjesët detare ashtu edhe ato tokësore.
- **Klima** - Përshkrimi i statistikave në kuptimin e mesatares dhe ndryshueshmërisë së sasive përkatëse gjatë një periudhe kohe që varion nga muaj në mijëra ose miliona vjet. Këto sasi janë më të mëdha në ndryshime sipërfaqësore si temperatura, reshjet dhe era.



3.1.3. SKEMAT E APLIKIMIT DHE DIAGRAMA UML PËR TEMËN “ZONAT ME PËRDORIM TË KUFIZUAR”

Skema e aplikimit për *Zonat me përdorim të kufizuar* përmban modelin konceptual thelbësor përcaktimin e zonave të krijuara në përputhje me kërkesat specifike legislative për të menaxhuar, kufizuar ose rregulluar aktivitetet për mbrojtjen e mjedisit. Një lloji i vetëm objekti gjeohapësinor “*Zonat me përdorim të kufizuar*” është përcaktuar për të përfaqësuar zonën si koncept të menaxhimit, kufizimit dhe rregullimit të mbivendosjes dhe shumë zona janë krijuar për të kryer të paktën dy nga tre konceptet.

Lloji i objektit gjeohapësinor i *Zonat me përdorim të kufizuar* përmban një grup thelbësor të veticë që janë të zakonshme për të gjitha llojet e zonave. Këto mund të kategorizohen në 3 grupe vetish:

1. Vetitë specifike të zonës: këto janë veti që ofrojnë një grup bazë informacioni duke përshkruar zonën.

- *Gjeometri:* Gjeometria paraqet shtrirjen gjeohapësinore të objektit gjeohapësinor. Në mënyrë tipike gjeometria e një zone do të përfaqësohet si një sipërfaqe ose shumë sipërfaqe. Sidoqoftë, mund të ketë ndonjë zonë që përfaqësohet si pikë ose linjë.
- *PeriudhaEPërcaktimit:* Periudha kohore që përcakton kur menaxhimi, kufizimi ose zona e rregullimit ishte caktuar me ligj ose u bë efektive në realitet.
- *AutoritetiKompetent:* Përshkrimi i menaxhimit përgjegjës të organizatës/organizatave duke kufizuar ose rregulluar masat ose aktivitetet brenda zonës.
- *BazaLigjore:* Referimi ose citimi i instrumentit legjislativ ose dokumentit që kërkoi krijimin e një zone.
- *Plani:* Për referencë, ose citim i një plani (menaxhimi ose plani i veprimit) që përshkruan objektivat dhe masat mjedisore që do të ndërmerren në zonë për të mbrojtur mjedisin.
- *NëLidhjeMeZonënReferuese:* Referencë për një ose më shumë *Zona me përdorim të kufizuar*.

2. Karakteristikat e klasifikimit dhe përzgjedhjes: për shkak të natyrës modelit të përgjithshëm shtesë u kërkuan veti për të bërë të mundur dallimin e llojeve të ndryshme të zonës. Këto janë të përcaktuara duke përdorur dy veti të klasifikimit:

- *LlojiIZonës:* Të cilat sigurojnë një klasifikim të nivelit të lartë të zonës. Ky është shpesh një klasifikim i përgjithësuar për të gjitha llojet e zonave për një zonë specifike tematike (P.sh. *ZonaEKufizimitTëShëndetitTëKafshëve*).
- *LlojiIIZonësSëSpecializuar:* Kjo lejon klasifikimin më specifik të zonës. Kjo do të jetë një lloj zone përkatëse e përcaktuar nga një domein i jashtëm ose kodlistë, aty ku është e mundur. Nëse nuk ekziston një kodlistë, atëherë ky do të jetë emri i përdorur në zonën brenda domeinit ose komunitetit (mundësisht në anglisht).
- *FushaMjedisore:* Është përfshirë për të mundësuar përdoruesit, për të térhequr shumëfish llojet e zonës që ekzistojnë brenda një domeini pasi u mor vesh që disa përdorues nuk e dinë se cilat lloje të zonës ekzistojnë.



3. Karakteristikat e identifikimit dhe mirëmbajtjes:

- *InspireId*: Është një objekt i jashtëm identifikues i publikuar nga ofruesi përgjegjës i të dhënave me qëllim që ato të munden të përdoren nga palët e treta për referim. Gjithashtu pasi zonat janë zakonisht "Njësi raportuese", ato gjithashtu kërkojnë identifikues të jashtëm të objekteve për t'i bërë të mundur që ato të referohen nga të dhënat e raportuara jogjeohapësinore.
- *Identifikuesit Tematik*: Janë identifikues shtesë që janë caktuar në zonë. Identifikuesit e shumtë të objektit tematik mund të caktohen në një zonë ku kërkesa të ndryshme për shkëmbimin e të dhënave (p.sh. raportimi kombëtar dhe evropian) kanë përcaktuar rregulla të ndryshme leksikore për identifikuesit tematikë të objektit. Kjo lejon të dhënrat e jashtme që përdorin këto identifikues tematikë për referencat përfundim.
- *Emri*: Emri i përdorur për të identifikuar *Zonat me përdorim të kufizuar* në realitet.
- *Fillimi/Ciklit/Jetësor*: Data dhe ora në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor ishte futur ose ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore.
- *Përfundimi/Ciklit/Jetësor*: Data dhe ora në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor u zëvendësua ose u tërroq nga grupi i të dhënave gjeohapësinore.

• Kodlistat

Kodlista *VleratEKoditTëLlojitTëZonës* përcakton një klasifikim të nivelit të lartë për llojin e *Zonat me përdorim të kufizuar*. Në kohën e zhvillimit të specifikimit të të dhënave është përcaktuar një listë fillestare e *VleratEKoditTëLlojitTëZonës* që përcakton fushën e fillimit të temës. Sidoqoftë, dihet që kjo kodlistë nuk përfshin të gjithë nivelin e lartë të llojeve të zonës në të gjitha fushat. Si rrjedhim, kjo kodlistë do të jetë duke përdorur cilëndo kodlistë për vlera të përcaktuar nga shtetet përgjegjëse dhe komunitetet tematike.

Për të zgjeruar këtë kodlistë, shtetet përgjegjëse dhe komunitetet tematike duhet të përcaktojnë vetëm një grup kodlistash që përcaktojnë llojet e reja të zonës së nivelit të lartë. Nëse lloji i propozuar i zonës bie brenda objektit të një *KodiTëLlojitTëZonës* ekzistues, atëherë kodi i propozuar i llojit të zonës duhet të përdoret si një *VleratEKoditTëLlojitTëZonësSëSpecializuar*.

Një shembull i lejueshëm i një bashkësie tematike ose zgjerimi i kodit të zonës së shtetit përkatës do të ishte: Zona e kufizimit të përdorimit të tokës.

Kodlista *VleratEKoditTëLlojitTëZonës* mundëson autoriteteve publike publikimin e çdo të dhënë që ata identifikojnë dhe që përfshihen në temën "Zonat me përdorim të kufizuar". Nëse zakonisht përdoren një sërë vlerash të zgjeruara të *VleratEKoditTëLlojitTëZonës*, atëherë komunitetet tematike dhe shtetet përgjegjëse duhet të propozojnë që këto vlera që përfshihen në kodlistat *VleratEKoditTëLlojitTëZonës* përmes procesit të Mirëmbajtjes së Specifikimit të të Dhënave.

Kodlista *VleratEFushësMjedisore* përcakton një sërë domeinesh të politikave mjedisore. Pritet që disa nga *Zonat me përdorim të kufizuar* të ndërpriten nga disa domeine të politikave mjedisore. Kur kjo ndodh, secili domein mjedisor duhet të përcaktohet.

Ndryshimet në kodlistat e domeinit mjedisor do të menaxhohen sipas procesit të Mirëmbajtjes së Specifikimit të të Dhënave.




Figura 6 – Diagrami i paketës UML: Paraqitura e skemës së aplikimit të Zonës së menaxhimit, kufizimit ose rregullimit




Figura 7 – Diagrama e paketës UML: Paraqitura e skemës së aplikimit të zonës së menaxhimit, kufizimit ose rregullimit




Figura 8 – Diagrama e klasës UML: Paraqitura e kodlistave të përfshira në skemën e aplikimit të zonave të menaxhimit, kufizimit ose rregullimit



Menaxhimi i identifikuesit

Objekteve gjeohapësinore të *Zonat me përdorim të kufizuar* do t'i caktohet një *InspireId* në përputhje me rregullat për menaxhimin e identifikuesit.

InspireId është e nevojshme për objektet gjeohapësinore të *Zonat me përdorim të kufizuar* për të mundësuar referencat nga burimet jo hapësinore që duhen krijuar. *InspireId* do të jetë një identifikues i qëndrueshëm, i jashtëm i objektit. Kjo do të thotë që *InspireId* do të sigurojë një identifikues të qëndrueshëm që mundëson që burimet e shumta jo hapësinore të lidhen me të njëjtën *Zonë me përdorim të kufizuar*.

Identifikuesi i caktuar si *InspireId* do të ndjekë katër kërkesat për identifikuesit e objektit të jashtëm:
Veçueshmëria: identifikuesit nuk do t'i caktohet ndonjë objekt gjeohapësinor.

Qëndrueshmëria: pasi të caktohet identifikuesi do të mbetet i pandryshuar gjatë kohës së një objekti gjeohapësinor.

Gjurmueshmëria: një objekt gjeohapësinor (ose version specifik) mund të arrihet bazuar në identifikuesin e tij.

Fizibiliteti: sistemi për përcaktimin e identifikuesve është krijuar për të lejuar identifikuesit ekzistues të përdoren.

InspireId përmban tre veti: *IdLokale*, *EmriGjeohapësinor* dhe një *Version «voidable»*.

Kur një shërbim i shkarkimit siguron qasje në versione të shumta të objekteve gjeohapësinore, parametri i versionit duhet të përfshihet për t'i mundësuar palëve të treta të përfshijnë versionin e objektit gjeohapësinor kur referohen.

Marrëdhënia midis *InspireId* dhe *IdTematic*

Shumë objekteve gjeohapësinore të *Zonat me përdorim të kufizuar* u janë caktuar identifikues të shumëfishtë bazuar në skema identifikuese të ndryshme që janë përcaktuar për shkëmbimin e të dhënavë për kërkesa specifike (p.sh. kombëtare kundrejt raportimit Evropian). Identifikuesit tematikë kanë qenë dhe do të vazhdojnë të janë çelësi i përdorur për të lidhur të dhënat jogjeohapësinore me objektit gjeohapësinore të *Zonat me përdorim të kufizuar*. Për të siguruar që asnjë prej këtyre identifikuesve dhe lidhja të mos humbasë, një *IdTematic* është shtuar në *Zonat me përdorim të kufizuar*.

Dallimi kryesor midis *InspireId* dhe *IdTematic* është që, *InspireId* duhet të jetë i vazhdueshëm, identifikues unik i cili mund të përdoret në të dhënat e jashtme për t'iu referuar objektit gjeohapësinor nga çdo palë e tretë. Ndërsa *IdTematic* është një identifikues unik përshtatshëm i objektit i caktuar për objektin gjeohapësinor të përcaktuar në një bashkësi informacioni.

Shënim: Një identifikues tematik mund të jetë pjesë e *InspireId*.

Disa objekteve gjeohapësinore të temës “*Zonat me përdorim të kufizuar*” mund ti caktohen më shumë se një identifikues tematik. Këta identifikues tematikë mund të caktohen për të përmbushur kërkesat e mirëmbajtjes për të dhënat e brendshme ose janë kode identifikimi të përcaktuara në nivel kombëtar, në nivel evropian ose ndërkombëtar. Shembull: Rrathët e baseneve lumore.

Shënim: Identifikuesi i brendshëm unik nuk duhet të publikohet pasi shërben si çelës kryesor i brendshëm dhe prandaj nuk është i përshtatshëm për t'u përdorur si një *InspireId* ose *IdTematic*.



Përfaqësimi i gjeometrisë

Përfaqësimi i gjeometrisë së Zonat me përdorim të kufizuar do të jetë ose një *Sipërfaqe* ose *Sipërfaqe E Shumëfishëtë*. Sidoqoftë, është njojur që në disa nivele të detajuara gjeometria mund të përfaqësohet ose si *Pika* ose *Kurba*. Si pasojë, çdo kufizim në përfaqësimin e gjeometrisë është hequr.

Nëse Zonat me përdorim të kufizuar duhet të përfaqësojë një zonë në realitet, atëherë gjeometria duhet të përfaqësohet si një *Sipërfaqe* ose *Sipërfaqe E Shumëfishëtë*.

Kur një nga Zonat me përdorim të kufizuar përbëhet nga pjesë të shumëfishta (d.m.th. sipërfaqe) vetëm një rast i objekteve gjeohapësinore Zonat me përdorim të kufizuar duhet të jetë i siguruar. Gjeometria duhet të përfaqësohet si një *Sipërfaqe E Shumëfishëtë*.

Përfaqësimi i kohëzgjatjes

Kohëzgjatja e një objekti gjeohapësinor të Zonat me përdorim të kufizuar përfaqësohet nga dy tipe të vërtive:

- Karakteristikat e ciklit jetësor transaksional: *Fillimi/Ciklit/Jetësor*, *Përfundimi/Ciklit/Jetësor*
- Veti e vlefshmërisë në realitet: *Percaktimi/Periodik*

Percaktimi/Periodik përcakton periudhën kohore (fillim Pozicioni dhe fund Pozicioni) kur Zonat me përdorim të kufizuar u përcaktuan me ligj ose u bënë efektive në realitet.

Percaktimi/Periodik përdor vetinë *Periodike* nga SSH EN ISO 19108. Kjo siguron fleksibilitet më të madh të kodimit të përmirësuar që përcakton në veçanti “EVlefshmePër” dhe “EVlefshmeNga” që përdorin xsd: *KohëDatë*.

Periodik implementohet duke përdorur gml: *LlojinKohorPeriodik*. Kërkon që të sigurohen *PozicioniFillestar* dhe *PozicioniPërfundimtar*. Nëse Zonat me përdorim të kufizuar nuk ka një përfundim të përcaktuar (d.m.th. është i panjohur), attributi i *PozicioniPërfundimtar* / *PozicioniINdërmjetëm* duhet të përdoret pér të deklaruar që Zonat me përdorim të kufizuar është efektive deri në një *PozicioniPërfundimtar*.

Vlerat që mund të përcaktohen janë fleksibël. *PozicioniFillestar* dhe *PozicioniPërfundimtar* përdorin llojin *Pozicioni* i cili është një bashkim i ISO 8601-1 dhe 8601-2 në datë, kohë ose *KohëDatë*.



3.1.4. KATALOGU I TIPOLOGJIVE

3.1.4.1. ZONA E MENAXHIMIT, KUFIZIMIT OSE RREGULLIMIT

-- Emri --

Zona e menaxhimit, kufizimit ose rregullimit

-- Përkufizimi --

Zona e menaxhuar, e kufizuar ose e rregulluar në përputhje me një kërkesë ligjore që lidhet me një politikë mjedisore, një politikë ose veprimtari që mund të ketë ndikim në mjedis në çdo nivel administritimi (ose përdoret për raportim në nivel ndërkombëtar, evropian, kombëtar, rajonal dhe lokal).

-- Tipi i elementit --

FeatureType

ATRIBUTET

♦ InspireId : Identifikues

Shumëlojshmëria: [1]

-- Emri --

InspireId

-- Përkufizim --

Identifikimi i objektit të jashtëm të objektit gjeohapësinor.

-- Përshkrim --

Një identifikues i objektit të jashtëm është një identifikues unik i objektit i publikuar nga organi përgjegjës, i cili mund të përdoret nga aplikimi i jashtëm për të referuar objektin gjeohapësinor. Identifikuesi është një identifikues i objektit gjeohapësinor, dhe jo një identifikues i fenomenit në realitet.

Shënim: Objektet gjeohapësinore të zonës së menaxhimit, kufizimit ose rregullimit zakonisht kryejnë rolin / funksionin e "Njësisë së raportimit" për të dhënat e raportuara jo hapësinore. Të dhënat e raportuara përbajnë referenca objektesh për zonën e menaxhimit, kufizimit ose rregullimit. Prandaj, të gjitha objekteve gjeohapësinore do t'u caktohet një InspireId.

[I detyrueshëm:PO]

♦ TematikId : identifikuesiTematik

Shumëlojshmëria: [0..*]

-- Emri --

Identifikuesi tematik

-- Përkufizimi --

Identifikuesi unik përshkrues i objektit i aplikuar për objektet gjeohapësinore në një temë informacioni të përcaktuar.

-- Përshkrimi --

Disa zona menaxhimi, kufizimi ose rregullimi mund të caktohen identifikues të shumëfishtë tematikë. Këto mund të janë krijuar për të përbushur kërkesat e raportimit të instrumenteve të ndryshme legislative në nivele ndërkombëtare, evropiane ose përshtetet që janë përgjegjëse për krijimin e këtij standardi.



ATRIBUTET

Aty ku ekzistojnë identitetë të shumta tematike, të gjitha duhet të sigurohen. Kjo do të lejojë që të gjitha të dhënat e jashtme që përdorin *IdTematica* për t'iu referuar zonës për të vazhduar të lidhen me objektin gjeohapësinor.

[I detyrueshëm:PO]

- ◆ Emri : EmërtimetGjeografike

Shumëlojshmëria: [0..*]

-- Emri --

Emri

-- Përkufizimi --

Një emër gjeografik që përdoret për të identifikuar zonën e menaxhimit, kufizimit ose rregullimit në realitet. Ai siguron një “çelës” për shoqërimin në mënyrë të nënkuptuar të përfaqësimëve të ndryshme të objektit.

[I detyrueshëm:PO]

- ◆ Gjeometri : GM_Objekt

Shumëlojshmëria: [1]

-- Emri --

Gjeometri

-- Përkufizimi --

Gjeometria që paraqet shtrirjen gjeohapësinore të objektit gjeohapësinor.

-- Përshkrim --

Gjeometria e një zone të menaxhimit, kufizimit ose rregullimit mund të përcaktohet duke përdorur çdo përfaqësim të gjeometrisë. Në mënyrë tipike kjo do të jetë ose një *Sipërsaqe* ose një *SipërsaqeTëMadhe*.

Shënim: Kur një zonë formohet si shumëkëndësh, kjo duhet të kodohet si një *Sipërsaqe* ose *SipërsaqeTëMadhe*.

[I detyrueshëm:PO]

- ◆ LlojiIZonës : KodiILlojitTëZonës

Shumëlojshmëria: [1..*]

-- Emri --

Lloji i zonës

-- Përkufizimi --

Klasifikim i nivelit të lartë që përcakton llojin e zonës së menaxhimit, kufizimit ose rregullimit.

[I detyrueshëm:PO]

- ◆ LlojiIZonësSëSpecializuar : KodiILlojitTëSpecializuarTëZonës

Shumëlojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Lloji i zonës së specializuar

-- Përkufizim --

Vlerë shtesë e klasifikimit që specializon më tej zonën e menaxhimit, rregullimit ose kufizimit të rëndësishme për domenin.



ATRIBUTET

-- Përshkrim --

Shënim: Kjo vlerë duhet të rrjedh nga një fjalor i kontrolluar specifik i fushës, kur është i disponueshëm.

Shembulli 1: Një zonë menaxhimi, kufizimi ose rregullimi ku vlera e llojit të zonës = Zona e Menaxhimit të Cilësisë së ajrit mund të klasifikohet më tej si:

- Lloji i specializuar i zonës = aglomerimi ose
- Lloji i specializuar i zonës = jo aglomerimi

Shembulli 2: Një zonë menaxhimi, kufizimi ose rregullimi ku vlera e llojit të zonës = Zonë e mbrojtur mund të klasifikohet më tej si:

Lloji i specializuar i zonës = zonë më pak e ndjeshme

Lloji i specializuar i zonës = nitratet më pak të ndjeshme

Lloji i specializuar i zonës = eutrofike më pak të ndjeshme

Lloji i specializuar i zonës = peshqit Shell më pak të ndjeshëm

[I detyrueshëm:PO]

❖ PeriudhaEPërcaktimit : Periudhë

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Periudha e përcaktimit

-- Përkufizimi --

Periudha kohore që përcakton kur zona e menaxhimit, kufizimit ose rregullimit u përcaktua me ligj ose u bë efektive në realitet.

-- Përshkrimi --

Shënim: Periudha e përcaktimit përdor SSH EN ISO 19108 *Periudha* e cila përbëhet nga dy veti - gml:
FillimPozicioni dhe gml: *PërfundimPozicioni*.

[I detyrueshëm:PO]

❖ FushaMjedisore : FushaMjedisore

Shumëllojshmëria: [1..*]

-- Emri --

Fusha mjedisore

-- Përkufizimi --

Klasifikimi i fushës/fushave të mjedisit për të cilin, përmes krijimit të zonës, do të arrihen objektiva të caktuara mjedisore.

-- Përshkrimi --

Një zonë mund të krijohet brenda një fushe mjedisore (p.sh. uji) ose mund të mbulojë një gamë të gjërë të objektivave mjedisore që ndërpresin disa fusha. Për shembull, rajonet detare mund të lidhen me ujin, përdorimin e tokës, zhvillimin e qëndrueshëm.

[I detyrueshëm:PO]

❖ AutoritetiKompetent : Palët përgjegjëse

Shumëllojshmëria: [1..*]

-- Emri --

**ATRIBUTET**

Autoriteti kompetent

-- Përkufizim --

Përshkrimi i autoritetit përgjegjës për administrimin, kufizimin ose rregullimin e masave ose aktiviteteve brenda zonës.

[I detyrueshëm:PO]

◆ FillimiICiklitJetësor : Datë-Orë

Shumëlojshmëria: [1]

-- Emri --

Fillimi i ciklit jetësor

-- Përkufizimi --

Data dhe ora në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor ishte futur ose ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore.

[I detyrueshëm:PO]

◆ PërfundimiICiklitJetësor : Datë-Orë

Shumëlojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Përfundimi i ciklit jetësor

-- Përkufizim --

Data dhe ora në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor u zëvendësua ose u tërhoq nga grupi i të dhënave gjeohapësinore.

[I detyrueshëm:PO]

◆ CitimiILegislacionit : Datë-Orë

Shumëlojshmëria: [1..*]

-- Emri --

Citimi i legislacionit

-- Përkufizimi --

Referencia për, ose citimin e instrumentit ligjor ose dokumentit që kërkon krijimi i zonës.

[I detyrueshëm:PO]

◆ NëLidhjeMeZonënReferuese : Datë-Orë

Shumëlojshmëria: [0..*]

-- Emri --

Zona e menaxhimit kufizimit ose rregullimit

-- Përkufizimi --

Referuar në një zonë që është e lidhur me menaxhimin, rregullimin ose kufizimin.

-- Përshkrimi --

Shembulli 1: Rrathët e baseneve të lumenjve (RBD)² ekzistonë në tre nivele:

² RBD – Rrethi i Pellgut të Lumin (River Basin District)

**ATRIBUTET**

- 1) Rrethi ndërkombe tar i pellgjeve të lumenjve
- 2) Rrethi kombëtar i pellgjeve të lumenjve
- 3) Njësitet e qarkut të baseneve lumore.

Një RBD ndërkombe tar mund të përbajë një ose më shumë njësi kombëtare RBD dhe / ose nën njësi të baseneve lumore.

Një RBD kombëtar mund të jetë e lidhur me një RBD ndërkombe tar dhe një ose më shumë nën njësi RBD.

Shembulli 2: Një WFD UjëratELarjes mund të jetë i lidhur me një qark të baseneve të lumit.

[I detyrueshëm:PO]

◆ Plani - Plan : Datë-Orë

Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri --

Citimi i dokumentit

-- Përkufizimi --

Referencia ose citimi i një plani (menaxhimi ose plani i veprimit) që përshkruan objektivat dhe masat mjedisore që do të ndërmerren në zonë për të mbrojtur mjedisin.

[I detyrueshëm:PO]

3.1.4.2. VLERAT E FUSHËS MJEDISORE**-- Emri --**

Vlerat e fushës mjedisore

-- Përkufizimi --

Fusha mjedisore, për të cilën mund të përcaktohen objektivat mjedisorë.

-- Identifikuesi --

<http://inspire.ec.europa.eu/codelist/EnvironmentalDomain>

-- Vlerat --

Vlerat e lejuara për këtë kodlistë përbajnjë vetëm vlerat e specifikuara në Aneksin C.

-- Tipi i elementit --

Kodlistë

3.1.4.3. VLERAT E KODIT TË LLOJIT TË ZONËS SË SPECIALIZUAR**-- Emri --**

Kodi i llojit të zonës së specializuar

-- Përkufizimi --



Vlerë shtesë e klasifikimit që përcakton llojin e specializuar të zonës.

-- Përshkrimi –

Për disa nga Zonat Menaxhimi Kufizimi Ose Rregullimit, secila zonë mund të specializohet më tej. Kjo përdoret për të treguar që kontrollet shtesë (aktivitete ose masa) mund të jenë në fuqi në varësi të llojit të tij të specializuar.

Shembull 1: Zonat Menaxhimi Të Cilësisë Së Ajrit – mund të specializohen si:

- Aglomerate
- Joaglomerate

Shembull 2: Zonat Kufizimi Të Shëndetit Të Kafshëve – mund të specializohen si:

- Zonë kufizuese
- Zonë mbrojtëse
- Zonë kontrolli
- Zona e rrezikut më të ulët
- Zona e mbikëqyrjes

-- Vlerat –

Vlerat e lejuara për këtë kodlistë përbajnjë çdo vlerë të përcaktuar nga të dhënata e ofruesit.

-- Tipi i elementit –

Kodlistë

3.1.4.4. VLERAT E KODIT TË LLOJIT TË ZONËS

-- Emri –

Vlerat e kodit të llojit të zonës

-- Përkufizimi --

Klasifikimi i nivelit të lartë që përcakton llojin e zonës së menaxhimit, kufizimit ose rregullimit.

-- Identifikuesi –

<http://inspire.ec.europa.eu/codelist/ZoneTypeCode>

-- Vlerat –

Vlerat e lejuara për këtë kodlistë përbajnjë vetëm vlerat e specifikuara në Aneksin C dhe vlera shtesë në çdo nivel të përcaktuar nga ofruesit e të dhënave.

-- Tipi i elementit –

Kodlistë



3.2. SKEMA E APLIKIMIT DHE DIAGRAMA UML PËR NËNTEMËN: “AKTIVITETET E KONTROLLUARA”

Skema e aplikimit të aktivitetave të kontrolluara duhet të përdoret për një *ZonëMenaxhimiKufizimiOseRregullimi* që përmban aktivitete specifike që kontrollohen (lejohen, ndalohen, promovohen ose kufizohen) brenda zonës. Këto aktivitete mund të kontrollohen për një periudhë të caktuar kohore.

Shembuj që përfshijnë aktivitetet e kontrolluara:

- Kufizimi i llojeve specifike të zhvillimit brenda një zone kufizuese të planifikimit gjeohapësinor (p.sh. nuk mund të ndërtojë ndërtesë më të madhe se një lartësi e specifikuar).
- Ndalimi i lëvizjeve të kafshëve dhe njerëzve gjatë shpërthimit të sëmundjes (p.sh. gripi i shpendëve).
- Lejimi i nxjerrjes së burimeve natyrore (minerale / ujë).
- Lejimi i emetimit të ndotësve.
- Kufizimi i nivelit të zhurmës gjatë orëve të veçanta të ditës.
- Kufizimi i gjuetisë gjatë periudhave të përcaktuara të viti.

Meqenëse tema “*Zonat me përdorim të kufizuar*” mbulon një gamë të gjerë fushash, nuk është e mundur të përcaktohej një grup përfundimtar i aktivitetave të kontrolluara që mund të modelohen brenda skemës konceptuale të kësaj teme. Përkundrazi, qëllimi ka qenë të identifikojë një grup të niveleve të larta të llojeve të veprimtarisë për të lehtësuar ndërveprimin duke përdorur pronën e aktivitetit në llojin e të dhënavë të *AktivitetiTëKontrolluar*. Lloji i saktë i aktivitetit që kontrollohet brenda zonës ku mund të specifikohet duke përdorur llojin e specializuar të aktivitetit dhe përshkrimit.

Aktivitetet kontrollohen gjithmonë përmes ndalimit, kufizimit ose lejes, nëpërmjet së cilës këto kontolle aplikohen për një periudhë të caktuar kohore. Një pronë e periudhës së kufizimit është përcaktuar duke përdorur llojin e të dhënavë të programit.

Qëllimi i llojit të të dhënavë të programit është të sigurojë një grup të dhënash me fleksibilitet të përgjithshëm, i cili mundëson kodimin e një game të rasteve të përdorimit të ndryshëm për periudha të kufizuara.

Kjo përfshin:

- Përcaktimi i një dite individuale ose të disa ditëve: Të hënën, fundjavat ose festat publike.
- Përcaktimi i një vargu ditësh: nga e hëna në të enjte.
- Përcaktimi i një sërë ditësh: e hënë, e martë, e enjte.
- Përcaktimi i një date ose varg datash: 2010-10-01 ose 2010-04-01 deri 2010-04-30.
- Përcaktimi i një dite / ose një sërë ditësh dhe periudhë kohore: e hënë mes 12:30-13:30, nga e hëna deri të enjten nga ora 9 e mëngjesit deri në orën 5 pasdite 2010-10-01 midis 12:30 dhe 17:00.

Shënim: Nëse përcaktohet vetëm një ditë, grup ose një varg ditësh /datash, atëherë supozohet se periudha e kufizuara aplikohet për 24 orë.

Meqenëse kjo zgjatje përcakton vetëm një karakteristikë shtesë: *AktivitetiTëKontrolluar*, ku përfaqëson kërkuesat për: lidhjen midis objekteve gjeohapësinore, menaxhimin e identifikuesit, modelimin e



referencave të objekteve gjeometrike dhe përfaqësimin e përkohshmërisë të përcaktuar për *KufiziminEMenaxhimitOseZonënERregullimit* që gjithashtu zbatohen këtu.




Figura 9 - Diagrama e paketës UML: Pasqyra e skemës së aplikimit të *Aktiviteteve të kontrolluara*.






Figura 10 - Diagrama e paketës UML: Pasqyra e skemës së aplikimit të *Aktiviteteve të kontrolluara*.




Figura 11 - Diagrama e paketës UML: Pasqyra e kodlistave të përfshira në skemën e aplikimit të *Aktiviteteve të kontrolluara*.



3.2.1. KATALOGU I TIPOLOGJIVE

3.2.1.1. DITA OSE DATA

-- Emri --

Dita ose data

-- Përkufizimi --

Zgjedhja për të specifikuar ditën ose datën e fillimit në të cilën zbatohet një kufizim nëse është një kufizim i planifikuar ose një datë specifike ose data e fillimit në të cilën aplikohet një kufizim.

-- Tipi i elementit --

Union

ATRIBUTET

♦ Dita:

Shumëlojshmëria: [1]

-- Emri --

Kodi i ditës së përcaktuar

-- Përkufizimi --

Një ditë e specifikuar

-- Vlerat --

Vlerat e lejuara për këtë kodlistë përbajnjë çdo vlerë të përcaktuar nga ofruesit e të dhënave.

[I detyrueshëm:PO]

♦ Data:

Shumëlojshmëria: [1]

-- Emri --

Data

-- Përkufizimi --

Një datë e specifikuar

[I detyrueshëm:PO]

3.2.1.2. INFORMACIONI I AKTIVITETIT TË KONTROLLUAR

-- Emri --

Informacioni i aktivitetit të kontrolluar

-- Përkufizimi --

Informacion që përshkruan llojin e veprimtarisë që kontrollohet brenda zonës.

-- Tipi i elementit --

***DataType*****ATRIBUTET**◆ **MasatEKontrollit:**

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Kodi i llojit të kontrollit

-- Përkufizimi --

Tipi i metodës së kontrollit të përdorur për të menaxhuar aktivitetet ose masat brenda zonës.

-- Përshkrimi --

Një aktivitet mund të kontrollohet duke përdorur tipa të ndryshëm të metodës, për të arritur tipa të ndryshëm objektivi.

Shembuj :

- Nxjerrje ujite ose nxjerra e mineraleve mund të rregullohet (d.m.th. të kërkojë leje) për të shmangur përdorimi e tepërt të një burimi.
- Lëvizjet e kafshëve mund të kufizohen ose ndalojen në rastin e një epidemie të shëndetit të kafshëve (p.sh. gjuha blu ose gripi i shpendëve).
- Gjuetia mund të lejohet ose ndalohet gjatë një periudhe të caktuar.

-- Vlerat --

Vlerat e lejuara për këtë listë kodesh përbajnjë çdo vlerë të përcaktuar nga ofruesit e të dhënave.

[I detyrueshëm:PO]

◆ **Aktivitetet :**

Shumëllojshmëria: [1..*]

-- Emri --

Lloji i aktivitetit të kontrolluar

-- Përkufizimi --

Tipi i aktivitetit që kontrollohet brenda zonës.

-- Përshkrimi --Ky është një zgjerim i kodlistës që përmban një klasifikim të niveleve të larta të zonave të aktivitetit. Tipi specifik i aktivitetit që kontrollohet duhet të përcaktohet duke përdorur *AktivitetinESpecializuar*.**-- Vlerat --**

Vlerat e lejuara për këtë kodlistëpërbajnjë çdo vlerë të përcaktuar nga ofruesit e të dhënave.

[I detyrueshëm:PO]

◆ **AktivitetiISpecializuar:**

Shumëllojshmëria: [1..*]

-- Emri --

Kodi i llojit të aktivitetit të specializuar

-- Përkufizimi --

**ATRIBUTET**

Tipi specifik i aktivitetit që përcakton aktivitetin që kontrollohet në zonë.

-- Përshkrimi --

Aktiviteti i specializuar është një kodlistë që duhet të rrjedhë nga kodlista tematike ose shteti përkatës. Aktiviteti i specializuar duhet të jetë një aktivitet përkatës që ka një përcaktim më të ngushtë se *TipiAktivitetitTëKontrolluar*.

Shembull: Nëse *TipiAktivitetitTëKontrolluar* është "ShëndetiIKafshëveDheBimëve", *AktivitetiISpecializuar* mund të jetë "lëvizje" ose më saktësisht "LëvizjaEKafshëve" dhe "LëvizjaENjerëzve" (nëse lëvizjet njerëzore në një zonë të kufizuar zbatohen siç ishte rasti me shpërthimin e sëmundjes në Britaninë e Madhe)

--Vlerat --

Vlerat e lejuara për këtë kodlistë përbajnjë çdo vlerë të përcaktuar nga ofruesit e të dhënave. Aneksi C përfshin vlerat e rekomanduara që mund të përdoren nga ofruesit e të dhënave.

[I detyrueshëm:PO]

◆ **Përshkrimi :**

Shumëlojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Informacion i detajuar

-- Përkufizimi --

Përbledhje narrative që jep çdo informacion shtesë që shpjegon se çfarë kontrollesh zbatohen për aktivitetin.

[I detyrueshëm:PO]

◆ **PeriudhaEKufizimit:**

Shumëlojshmëria: [0..*]

-- Emri --

Orari

-- Përkufizimi --

Periudha kohore që përcakton kur zbatohen kufizimet.

-- Përshkrimi --

Shënim: Kontrolllet specifike mund të zbatohen për aktivitetet ose masat brenda periudhave kohore të përcaktuara Ekzistojnë disa raste kyçe të përdorimit për përcaktimin e një programi për një aktivitet siç është një kufizim: Përcaktioni një ditë ose disa ditë : E hënë, fundjavë ose pushime publike.

Përcaktioni një varg ditësh: E hënë deri të enjten.

Përcaktioni një sërë ditësh: e hënë, e martë, e enjte.

